BULETINI XII DHJETOR 2019

Vrapo Babadimër

Me 15 dhjetor, 2019 është mbajtur mini maratona humanitare “Vrapo Babadimër” e organizuar nga “Projekti 5 cent” në sheshin Zahir Pajaziti.

Qëllimi i kësaj maratone ishte të mbledhen fonde duke i shitur rrobat e babadimrit, dhe të gjithë të veshur si babadimër të vrapojnë 5 Km. Fondet e mbledhura u shfrytëzuan për familjet me kushte të rënda ekonomiko-sociale me rastin e festave të fund vitit.

Në këtë mini maratonë morrën pjesë edhe 68 fëmijë të cilët janë pjesë e Qendrës Mësimore të BSFK në Fushë Kosovë. Pjesëmarrja e tyre u mundësua nga kompania Kujtesa, e cila ju dhuroi 68 fëmijëve rroba të babadimrit të cilët më pas vrapuan dhe u argëtuan me shfaqjen e cila ishte organizuar në mini maratonën “Vrapo Babadimër”.

Duke u bërë pjesë e Vrapo Babadimër, të gjithë kontribuan të jenë arsyeja e buzëqeshjes së dikujt, në festat e fundvitit.

Thirrje për implementimin e "Udhëzimit Administrativ" (19/2018)

Me datë 3 dhjetor, 2019 pranë objektit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë – MAShT nga Organizatat e shoqërisë civile të cilat menaxhojnë Qendrat Mësimore, është organizuar një thirrje si Iniciativë Avokuese për shtyerjen e implementimit të "Udhëzimit Administrativ" (19/2018) për regjistrimin dhe funksionimin e qendrave mësimore.

Kjo thirrje ka pas për qellim t'ia rikujtoj Ministrit të Arsimit z. Bytyqit premtimet të cilat nuk i ka realizuar sipas datës së afatit të përcaktuar me UA të cilin udhëzim vetë Ministri e ka nënshkruar me 7 dhjetor 2018 (19/2018). Duke qenë se ky udhëzues nuk është shpërndarë brenda datës së afatit të përcaktuar, qendrat e mësimit shtesë janë duke u përballuar me një sërë sfidash për shkak të mungesës së financimit dhe nenglizhencës së përgjegjësive institucionale.

Qytetarët që iu bashkuan kësaj thirrje si dhe të gjithë tutorët e qendrave mësimore sot kanë kërkuar nga MAShT që në mënyrë urgjente të nxjerrin (Udhëzuesin e Regjstrimit të këtyre Qendrave Mësimore) dhe rrjedhimisht të hap procesin zyrtar për regjistrimin e Qendrat ët Mësimit Shtesë dhe në të njejtën kohë të publikoj thirrje për subvencione financiare siç përcaktohet në buxhetin vjetor të qeverisë së Kosovës.

Takim i përfaqësuesve të OSHQ me z. Albin Kurtin

Me 21 dhjetor, 2019, në zyrën e Lëvizjes VETËVENDOSJE!, Kryetari Albin Kurti, së bashku me nënkryetaren Fatmire Mulhaxha Kollçaku dhe anëtarët e kryesisë Xhelal Sveçla dhe Sami Kurteshi, pritën në takim përfaqësuesit e shoqërisë civile që merren me mbrojtjen dhe avancimin e interesave të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian në Kosovë.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas e vuajnë dyfish varfërinë dhe papunësinë në Republikën tonë, kjo për shkak të paragjykimeve dhe diskriminimeve shtesë që atyre u bëhen. Për 20 vite me radhë, ata kanë qenë të neglizhuar nga qeverisja dhe përveçse nuk u janë garantuar të drejtat dhe liritë, u ka munguar edhe qasja në punësim, shëndetësi, edukim, mbrojtje sociale dhe kujdes.

Kjo nuk mund të vazhdojë edhe me qeverisjen e re, andaj, pas konsultimit me përfaqësuesit politik e institucional të këtyre komuniteteve, Kryetari Kurti priti në takim edhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që mbrojnë interesat e romëve, ashkalive dhe egjiptasve në Kosovë, me të cilët bashkëbisedoi për koordinatat e një qeverisje të re që nuk përjashton askë por që interesohet, mbron dhe mundëson përparimin e aktiviteteve dhe politikave në të mirë të këtyre komuniteteve dhe shoqërisë në përgjithësi.

Përfaqësuesit e këtyre organizatave kanë listuar çështjet më të rëndësishme për përmirësimin e mirëqenies së këtyre tri komuniteteve ku prinë edukimi dhe arsimimi, punësimi, banimi, buxheti i përgjithshëm dhe anti-gjipsizmi.

Kryetari Kurti shprehu vlerësimin e tij për punën e bërë nga këto organizata dhe i njoftoi përfaqësuesit e tyre me prioritetet e qeverisë së re, ku shtetndërtimi demokratik dhe sundimi i ligjit, zhvillimi ekonomik e krijimi i vendeve të punës nuk do të përjashtojë e diskriminojë më askë. Me qeverinë e re aty ku ka nevojë më së shumti do të ndihmojmë më së pari dhe ne e dimë që komunitetet e romëve, ashkalive dhe egjiptasve e ka një barrë të dyfishtë ngase janë të diskriminuar në një mënyrë të veçantë brenda të diskriminuarve në përgjithësi, tha ai, duke potencuar që kjo do të ndryshojë. Qeveria e re do e orientojë energjinë drejt projekteve që prekin dhe zhvillojnë drejtpërdrejt jetën e këtyre komuniteteve dhe këtu do të përfshijmë sidomos përkrahjen e organizimeve dhe aktiviteteve që mbrojnë dhe avancojnë interesat e tyre.

Për këtë, tashmë kemi edhe dakordim me përfaqësuesit institucional, por edhe me organizatat joqeveritare që merren me mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të këtyre komuniteteve.

Shpërndarja e dhuratave për fëmijë

Me 20 dhjetor, 2019 në kuadër të projektit "Fuqizimi i komuniteteve jo-shumicë në Kosovë përmes arsimit, dialogut dhe përfshirjes në proceset e vendimmarrjes komunale" EDI- Faza e tretë, është organizuar ngjarja për shpërndarjen e dhuratave për fëmijët përfitues të projektit, nga katër lokacionet ku vepron projekti (Shtime, Plemetin, Fushë Kosovë dhe Janjevë).

Dhuratat për fëmijë janë përgatitur nga nxënësit e shkollave: Mileniumi i Tretë, Prishtina High School, ILG,

Shkolla Zenit, kursi i gjuhëvë të huaja Oxford Studio, dhe nga stafi i Gjiarafa Mall dhe IPKO Foundation. Ndërsa ngjarja është përkrahur nga Forca e Sigurisë së Kosovës – FSK, Misioni i OSCE-së në Kosovë, Komuna e Fushë Kosovës dhe Komuna e Obiliqit.

Të shoqëruar nga stafi i tri organizatave partnere: Balkan Sunfloëers Kosova, Play International dhe The Ideas Partnership, në këtë ngjarje morren pjesë më shumë se 460 fëmijë, të cilët morrën dhurata. Pas shpërndarjes së dhuratave, pati edhe një koktell rasti për të gjithë pjesëmarrësit.

Trajnimi " Aplikimi i Suksesshëm

Në kuadër te projektit PROSPECT+ financuar nga KFOS dhe implementuar nga "Syri i Vizionit" gjatë dhjetorit, janë mbajtur trajnime për lehtësimin e aplikimit të suksesshëm për punësim, në të cilat trajnime do të trajnohen të rinjët e komuniteteve Rome, Egjiptian dhe Ashkalinjë në Pejë gjegjësisht lagjen "7 Shtatori".

Qëllimi i trajnimit është vetëdijësimi i aplikimit të suksesshëm tek të rinjët, format, mënyrat, dhe praktikat e lehta të aplikimit, siç janë: plotësimi i aplikacionit, CV, letra motivuese dhe referuese.

Në kuadër të këtij projekti është angazhuar këshilltari për punësim i cili do të merret vetëm me çështjet e punësimit dhe informimin e të rinjëve për punësim.

Trajnimi "Shkathtësit Prindërore"

Në kuadër të projektit PROSPECT+ financuar nga KFOS dhe impelmentuar nga "Syri i Vizionit, në lagjen "7Shtatori" janë mbajtur trajnime për prindërimin e përditshëm apo "Shkathtësitë Prindërore" i cili trajnim u mbajt me gratë, nënat dhe vajzat e reja të komuniteteve Rome, Egjiptian dhe Ashkalinjë .

Qëllimi i trajnimit është lehtësimi në rritjen e fëmijëve, gjetja e mënyrave apo formave më praktike për të punuar më fëmijët kryesisht në detyrat e shtëpise, duke marë parasysh që prindërti e komuniteteve Rome, Egjiptian dhe Ashkalinje nivelin e dukimit e kanë të ulët.

Në kuadër të këtij projekti është e angazhuar dhe një psikologe e cila mban seanca psiko- sociale me nënat, vajzat dhe gratë e komuniteteve Rome, Egjiptian dhe Ashkalinjë , ofron shërbime psikologjike për të trajtuar stresin, dhunën, problemet familjare, depresionin, vetëdijësimin për maresat e hershme.

Bursa për nxënësit e shkollave të mesme të larta

Me 13 dhjetor, 2019, nga 550 përfitues të bursave për vitin shkollor 2019/20, 150 përfitues nga Voice of Roma, Ashkali and Egyptians in Kosovo kanë nënshkruar kontratat e tyre në kuadër të projektit "Programi Kombëtar i Bursave për nxënësit e shkollave të mesme të larta të komuniteteve Rom, ashkali dhe egjiptian". Ky projekt përkrahet nga fondacioni Zvicerian (HEKS) Zyra e Zviceriane për bashkëpunim dhe Fondi Arsimor për Romët, "Roma Education" Fund (REF) i mbështetur nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), ndërsa implementohet nga Zëri i Romëve Ashkalive dhe Egjiptasëve (VoRAE).

Shfaqja teatrale “Home”



Me 19 Dhjetor 2019, në Ferizaj është organizaur një program kulturor – artistik dhe shfaqja teatrale “Home” nga BRAN. Ky program mblodhi afër 400 pjesëmarrës në teatrin “Adriana Abdullahu” në Ferizaj. Njëkohësishtë ky aktivitet ishte edhe përmbyllja e projektit “Përfshirja e të kthyerve në shoqërin kosovare” të implementuar nga Bashkimi Rinor E Ardhmja E Ndritur dhe mbështetur financiarishtë nga UNHCR.

Në këtë ngjarje ishin pjesëmarrës edhe zv.ministrat, përfaqësues të institucioneve lokale, përfaqësues të UNHCR-së, pjesëtarë të shoqërisë civile, drejtor, profesorë e arsimtar të shkollave fillore e të mesme të komunës së Ferizajit dhe akter të tjerë.

Shfaqja teatrale me emrin “Home” trajtoi problematikat dhe sfidat për të kthyerit nga vendet e rajonit, mirëpo, mbi të gjitha shfaqja përcjelli mesazhe ku kërkohet respektim të drejtave të njeriut, zbatim të ligjeve, udhëzimeve e rregulloreve për të kthyerit, ndërtim të shtëpive, ofrim të kushteve për shkollim të fëmijëve, punësim, kushte më të mira shëndetësore e në përgjithësi trajtim më të mirë për të kthyerit pasi që vlerësohet se janë lënë anash krejtësishtë. Përveq shfaqjes “Home” përformuan edhe grupi i vallëzimit Hip Hop “Fly Dancers”.

BRAN do të vazhdojë të punoj dhe të angazhohet për përfshirjen e të kthyerve në shoqërin kosovare.

Shpërndarja e dhuratave në Pejë

Me 26 dhjetor, 2019, në kuadër të projektit “GIZ” i cili implementohet nga “Syri I Vizionit” në Pejë për festat e fundvitit janë ndarë pako shkollore per të gjithë fëmijët e mësimit plotësues të 6 qendrave mësimore në Komunën e Pejës. Dhuratat kanë përmbajt përveç gjërave ushqimore, gjithashtu edhe nga një libër përallash për ta lexuar gjatë pushimeve dimërore. Me këtë rast nxënësit e mësimit plotësues dhe edukatoret organizuan një aktivitet argëtues.

Trjanim: Strategjitë moderne të mësimdhënies

Për ndër të ditës së vullnetarëve, në kuadër të projektit EDI 3, të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim, TIP organizojë trajnimin “Strategjitë moderne të mësimdhënies” me trajnerët Fitore Polloshka, Feride Fejza dhe Valentina Osmani.

Përmës ketij trajnimi TIP synoj që t’i zhvillojë aftësit e vullnetarëve për teorite modern të mësimdhënies, strategjitë e mësimdhënies konstruktiviste dhe vlerësimin e nxënësve si proces i pa ndarë i mësimdhënies.

Trajnimi në përgjithësi ka pasur për qëllim lehtësimin e implementimit të planprogramit mësimor në aktivitetet më fëmijë.

Të rinjët bëjnë ndryshime

Me 27 dhjetor, Balkan Sunflowers Kosova organizoi një ngjarje lidhur me hulumtimin "Problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen komunitetet Ashkali, Egjiptian dhe Rom në Komunën e Fushë Kosovës dhe Ndërtesat Sociale të fshatit Plemetinë në Komunën e Obiliqit" në amfiteatrin e hekurudhave të Fushë Kosovë. Mesazhi ki kësaj ngjarje ishte "Të rinjët bëjnë ndryshime". Në këtë ngjarje morrën pjesë mbi 300 qytetarë të komuniteteve Ashkali, Egjiptian dhe Rom. Të pranishim ishin edhe përfaqesuesit e institucioneve shëndetësore nga këto dy komuna.

15 të rinjë nga këto tri komunitete dëshmuan që kur ekziston vullneti ndryshimet gjithsesi ndodhin. Brenda një muaji këta të rinjë kanë intervistuar 502 familje, duke përfshi 384 familje Ashkali, 76 familje Egjiptjane, 36 familje Rome, dhe 6 familje te cilat nuk janë deklaruar. Të gjeturat kryesore u paraqiten para audiencës.

Këta të rinjë nuk kanë ndaluar këtu. Ata brenda dy javëve të ushtrimeve të përditshme intenzive kanë pergaditur shfaqjen lidhur me martesat e hershme "Nuk të bëhet vonë". Shfaqja teatrale u prezantua në këtë ngjarje dhe u mirëprit nga të pranishmit.

Të rinjët nga OJQ BRAN poashtu performuan një vallëzim modern dhe treguan që të rinjët nga keto tri komunitete janë artistë të fushve të ndryshme.

Projekti u financua nga Solidare Suise zyra ne Kosovë.

Shpërndarja e dhuratave në Mitrovicë

Me datën 24 dhjetor 2019, RADC organizoi një aktivitet për të shpërndarë dhurata tek fëmijët që vijonë mësimin shtëse tek Qendra Mësimore në Mitrovicë, Gjatë aktiviteti u shpërndanë dhurata të ndryshme për vitin e ri për 200 fëmijë. Qendra mësimore në Mitrovicë dhe ky aktivitet u mbështetën nga SIDA/DRC.

Gëzuar Vítí í Rí 2020!